



Tiranë, më 05.02.2021

Lënda: Udhëzues mbi strukturimin e temave të Diplomave për studentët e Ciklit të Parë dhe të Dytë të Studimeve – Departamenti i Burimeve të Energjisë

Departamenti i Burimeve të Energjisë, për shkak të kërkesave të disa prej udhëheqësve të diplomave të studentëve të DBE – Dy Nivelet, në mbledhjen e tij të datës 08 Shkurt 2018 mori në shqyrtim dhe

V E N D O S I

Që Punimi i Pavarur Përfundimtar/Projekt Diploma (PPP/PD) duhet të ketë strukturën si vijon:

- **HYRJA** – Në të paraqitet tema në tërësinë e saj sipas kapitujve përbërës, puna e bërë në tërësi, kontributi personal (puna e tij) i diplomantit për realizimin e saj si dhe arrijtet kryesore të saj, së bashku me falenderimet e rastit, nëse studenti dëshiron ti shprehë;
- **Kapitulli 1 – Të dhëna të përgjithshme** (me emërtim individual sipas këndvështrimit të udhëheqësit). Ky është një kapitull sinteze bibliografike ku kandidati paraqet gjendjen e problemit që trajton PPP/PD sipas të dhënave të literaturës që ai ka studiuar (afërsisht 3-5 faqe);
- **Kapitulli 2 – Metodologjia** (me emërtim individual sipas këndvështrimit të udhëheqësit). Këtu jepen me hollësi metodat e kryerjes së studimit (punime në terren nëqoftëse ka, të dhënat e marra në kantier apo studio, zgjedhja e kampionaturës ose materialit tjetër parësor, metodat e analizës dhe përpunimit të të dhënave, afërsisht 3-5 faqe);
- **Kapitulli 3 – Rezultatet dhe diskutimi i tyre** (me emërtim individual sipas këndvështrimit të udhëheqësit). Këtu jepen rezultatet e fituara. Ato paraqiten në tabela dhe grafikë (hartat/prerje/diagrama). Diskutimi i rezultateve bëhet duke ju referuar rezultateve dhe të dhënave të përmendura në kapitullin 1 dhe 2. Kapitulli mbyllet me interpretimin e rezultateve. Ky kapitull duhet të ketë afërsisht 15-20 faqe;
- **Kapitulli 4 – Përfundime dhe rekomandime.** Ky kapitull në jo më pak se dy faqe, paraqitet me pika të veçanta të gjitha përfundimet e punimit si dhe rekomandimet përkatëse të tij;
- **Kapitulli 5 – Literatura.** Në të do të shënohen të gjitha materialet e shfrytëzuara për trajtimin e PPP/PD si libra, cikël leksionesh, artikuj. Numri i tyre (jo lloji) rekomandohet të jetë jo më pak se 10. Të gjithë titujt e materialeve duhet të jenë të referuar në tekst me numrin rendor të tyre. Çdo material përmban: *autorin, titullin, faqet e shfrytëzuara, vitin dhe vendin e botimit.* Kur materiali është marrë nga interneti, në vend të vitit dhe vendit të botimit, shënohet linku (nyja) përkatës i tij ku është gjendur.

Shtojcat – Në fund, projekt diploma mund të përmbajë një apo më shumë Shtojca ku autori paraqet materiale plotësuese në formë tabelash /fotografish etj., për rastet kur numri i tyre është i konsiderueshëm dhe futja në tekst do të fragmentizonte së tepërmi PPP/PD.

Të rëndësishme:

- PPP/PD shkruhet në kompjuter në format A4 (me margjina 2.5 cm në çdo anë), teksti Times New Roman, madhësia 12pt, hapësira ndërmjet rreshtave 1.5 dhe duhet

të jetë, së bashku me figurat, grafikët, fotot apo tabelat e ndërfutura (pa anekset e rastit) ndërmjet 30 dhe 50 faqesh. Një kopje e shtypur në letër format A4 e lidhur si dhe CD-ja përkatëse me përmbajtjen e saj dorëzohen në departament sipas datës e cila do të publikohet në mjediset e DBE;

- Përmbajtja e projekt diplomës përgatitet në rreth 12-15 slide në Power Point (ppt) dhe mbrohet para komisionit përkatës të propozuar nga DBE dhe miratuar nga Dekani për një kohë jo më të gjatë se 15/20/25 minuta.

Kronologjia e ecures së përgatitjes:

- Caktimi i udhëheqësve dhe dhënia e temave të PPP/PD. Takimi me udhëheqësin dhe përcaktimi i planit të punës për hartimin e PPP/PD (sipas datës e cila do të publikohet në mjediset e DBE);
- Paraqitja e planit të punës në zyrën e Departamentit të Burimeve të Energjisë (DBE), për dokumentimin zyrtar paraprak të saj (sipas datës e cila do të publikohet në mjediset e DBE);
- Konsultime të detyrueshme dhe të dokumentueshme me udhëheqësin (1 ditë në javë);
- Kontrolli i parë në DBE i PPP/PD (sipas datës e cila do të publikohet në mjediset e DBE). Studenti do të paraqisë për vlerësim:
 - Strukturën Paraprake të Temës së Diplomës;
 - Literaturën (titujt);
 - Materialet në versionin fillestar të tyre.Kjo hollësi do të pasqyrohet në PPP/PD, duke bashkëngjitur formularin përkatës;
- Kontrolli i dytë në DBE i PPP/PD (sipas datës e cila do të publikohet në mjediset e DBE). Studenti do të paraqisë për vlerësim:
 - Strukturën Përfundimtare të Temës së Diplomës;
 - Literaturën e plotë;
 - Materialet e plotë.Kjo hollësi do të pasqyrohet në PPP/PD, duke bashkëngjitur formularin përkatës;
- Shkrimi i PPP/PD, përgatitja e materialit paraqitës dhe dorëzimi i saj.

***Shënim:** Nuk do të pranohet asnjë PPP/PD që nuk ka kaluar në mënyrë të dokumentuar hapat e parashikuara më lart.*

Përgjegjësi i Departamentit

Nevton KODHELAJ